VENDIM
Nr.235, datë 23.3.2011

PËR KALIMIN NË PRONËSI, TË BASHKISË SARANDË, TË SIPËRFAQES 9200 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.206 "REZIDENCA QEVERITARE SARANDË", PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1058, DATË 16.7.2008 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE", TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.20, DATË 9.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SARANDË TË QARKUT TË VLORËS"

(Ndryshuar me VKM nr. 305, datë 29.4.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të neneve 3, 7, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë Sarandë, të qarkut të Vlorës, të sipërfaqes 9200 (nëntë mijë e dyqind) m² nga trualli funksional i pronës nr.206, me emërtim "Rezidenca qeveritare Sarandë", sipas studimit pjesor urbanistik bashkëlidhur, i cili ndodhet në përgjegjësi administrimi të Këshillit të Ministrave, për ta përdorur për ndërtimin e një shkolle 9-vjeçare *dhe zhvillimin e programeve parauniversitare.*

2. Në listën e pronave të paluajtshme publike, që i bashkëlidhet vendimit nr.1058, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të hiqet sipërfaqja prej 9200 (nëntë mijë e dyqind) m², nga prona nr.206.

3. Në listën paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Sarandë, të qarkut të Vlorës, që i bashkëlidhet vendimit nr.20, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet prona me nr.206/1, me sipërfaqe 9200 (nëntë mijë e dyqind) m².

4. Bashkia Sarandë ndalohet të ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së përcaktuar në këtë vendim.

5. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare detyrohet të bëjë kalimin në pronësi të kësaj sipërfaqeje, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë, dhe bashkia Sarandë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për

kalimin në pronësi të kësaj sipërfaqeje, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha